# VENDIM
# Nr. 102/2026

## PËR NGRITJEN E NËNKOMISIONIT PËR INTEGRITETIN E INFORMACIONIT PUBLIK, DEZINFORMIMIN DHE NDËRHYRJET E HUAJA

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 19, pika 2, 21, pika 1, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngritjen e Nënkomisionit për Integritetin e Informacionit Publik, Dezinformimin dhe Ndërhyrjet e Huaja në përbërje të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

II. Fusha e përgjegjësisë së këtij Nënkomisioni përfshin ndjekjen, analizimin dhe trajtimin e çështjeve që lidhen me ndërhyrjet e huaja, dezinformimin dhe manipulimin informativ, mbrojtjen e proceseve demokratike dhe integritetit të informacionit publik, lirinë e medias, si dhe politikat, mekanizmat institucionalë dhe zhvillimet teknologjike që ndikojnë në mjedisin informativ dhe digjital.

III. Nënkomisioni përbëhet nga 5 anëtarë, si më poshtë:

| | | |
|---|---|---|
| 1. Iris Luarasi | kryetare | PS; |
| 2. Agron Gjekmarkaj | zëvendëskryetar | PD; |
| 3. Ardit Bido | anëtar | PS; |
| 4. Arbjan Mazniku | anëtar | PS; |
| 5. Greta Bardeli | anëtare | AN. |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
**Niko Peleshi**

Miratuar në datën 18.6.2026.